

There are no translations available.



25 vjet me pare ne mars 1991 u themelua BSPSH , sindikate e cila lindi ne kushtet e diktatures komuniste si domosdoshmeri per permbysjen e saj dhe per te shprehur ne vazhdimesi mbrojtjen e e interesave social ekonomike te punonjesve ne kushtet e nje shoqerie pluraliste demokratike.

Ne kete kuader Keshilli Kombetar i BSPSH mori vendimin per te festuar kete eveniment te rendesishem ne dt. 26.03.2016 ne Tirane ku moren pjese mbi 1000 perfaqesues te strukturave sindikale te profesioneve dhe strukturave sindikale Rajonale si dhe themelues te BSPSH ne vitin 1991.

Ne kete ngjarje te rendesishme ishin te ftuar perfaqesues te pushtetit qendror dhe vendor, perfaqesues te opozites, te sindikatave homologe, perfaqesues te organizatave te

punedhenesve dhe të shoqërisë civile. Gjithashtu ishte ftuar Ministri i Mireqenies Sociale dhe Rinisë z. Blendi Klosi, por nuk ishte prezent për shkak se ndodhej me shërbim në SHBA.

Konferencën e nderuan me pjesëmarrjen e tyre përfaqësues të organizatave Sindikale nga vende të ndryshme të Europës.

Konferenca u hap me Dokumentarin e BSPSH, i cili tregon historinë e lëvizjes Sindikale në vitin 1991, si dhe përjekjet e BSPSH dhe Sindikates së Pavarur të Minatoreve të Shqipërisë për përmbysjen e regjimit komunist.

Greva e Urisë e Minatoreve të Valiasit, ku 17 minatore midis tyre dhe Presidenti Gezim Kalaja u futen në Minierën e Valiasit për liri a vdekje. Ky akt sublim solli pluralizmin politik në Shqipëri dhe demokracinë.

Pas dokumentarit të BSPSH u shfaq video - mesazhi i ardhur nga AFL - CIO si një bashkëpunëtor për mbështetjen e BSPSH dhe SPMSH në luftën për liri dhe demokraci.

Në këtë ngjarje të rëndësishme u shfaq video – mesazhi nga Sekretarja e Përgjithshme e ITUC znj. Sharan Burrow, që u mireprit nga grata sindikaliste për mbështetjen e vecante të ITUC dhe BSPSH.

Pas këtyre mesazheve shumë të rëndësishme që percolen shumë emocione tek të gjithë anëtarët, fjalën e rrathës e mbajti Presidenti i BSPSH z. Gezim Kalaja, duke bërë një ekspozitë të veprimtarisë 25 vjeçare të BSPSH si dhe objektivat kryesore mbështetur në politikat e ITUC dhe Direktivat e BE për periudhën 2016 - 2020.

Në këtë event percolli urimet e saj znj. Enisa Salimovic si përfaqësuese e ITUC - PERC, z. Tomas Cook si ish-përfaqësues i Sindikatave Angleze në vitin 1991, përfaqësuesi i UIL (Itali) z. Giovanni Firera, z. Mahmut Arslan(HAKISH), z. Xhemal Bakindi(TOLEYIS), z. Haxhi Arifi(BSPK), z. Ali Yalcin(MEMURSEN) Egjipt(Ahmed El Feky).

Ne kete event u vleresua kontributi 25 vjecar i BSPSH dhe SPMSH nga Presidenti i Republikes se Shqiperise z. Bujar Nishani i cili dekoroi me medaljet me te larta te shtetit Shqiptar.

Medalja "Gjergj Kastriot Skenderbeu " ju dha BSPSH me Motivacionin " Per rolin e vecante : Ne levizjen punetore te vendit tone dhe permbyshjen e diktatures komuniste, mbrojtjen e stabilitetit, permiresimin e kushteve sociale, mbrojtjen e interesave, lirive dhe te drejtave te punonjesve, respektimin e bashkepunimit, dialogut social si dhe per integrimin e Shqiperise ne Institucionet Nderkombetare " - Dekreti nr. 9490 te dt. 25.03.2016.

SPMSH u dekorua me medaljen " Shqiponja e Arte " me motivacionin; " Dekorata e Arte e Shqiponjes " Per kontribut te shquar ne levizjen sindikaliste te vitit 1991, qe kulmon me aktin sublim te greves se urise se minatoreve, e cila beri te mundur rrezimin e dikatures Komuniste dhe hapjen e rruges per transformime te medha demokratike ne Shqiperi " - Dekreti nr. 9491 i dt. 25.03.2016!

Gjithashtu Presidenti i Republikes se Shqiperise dekoroi me medaljen " Pishtar i Demokracise" 5 sindikalistet;

1. **Znj.Pranvera Bodinaku - Presidente e Sindikates se Tregetise dhe Turizmit**
2. **Znj. Hatixhe Borici - Kryetar e BSP Rrethi Lushnje**
3. **z. Nevruz Kaptelli - President i Sindikates se Arsimit Shqiptar**
4. **z. Koco Jani - Sekretar Organizativ ne BSPSH**
5. **z.Myftar Ismalaja - President i SPILT**

Sekretari Organizativ i BSPSH

z. Koco Jani







